



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.584/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevc, kryesues, Rustem Thaçi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Majlinda Lllolluni me vendbanim në Gjermani, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.09.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**Hidhet i parregullt** apeli Anr.584/2021 i paraqitur nga Majlinda Lllolluni me vendbanim në Gjermani, me të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

### A r s y e t i m

Me datën 01.09.2021 PZAP-i ka pranuar një apel nga Majlinda Lllolluni me vendbanim në Gjermani në të cilin pretendon se KQZ nuk e ka përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës edhe pse se siç thekson ajo i plotëson të gjitha kriteret për aplikim ka aplikuar nga adresa e bashkëshortit të saj e ai është në listë ndërsa kjo nuk është.

Parashtruesi i apelit, apelit i ka bashkangjitur kërkesën me emailin për aplikim në KQZ për Mirlinda Lllolluni, formularin e aplikimit dhe dokumentin identifikuese/pasaportën për Mirlinda Lllolluni .

Paneli, pasi që vlerësoj apelin gjeti se i njëjti është **i parregullt**, për këto arsye:

Paneli, nga shkresat e lëndës vlerësoj se apeli i paraqitur, është i parregullt, pasi që apeli i paraqitur në PZAP, është i paraqitur në emër të Majlinda Lllolluni, ndërsa kërkesa e paraqitur në KQZ, për regjistrim si votues jashtë Kosovës, së bashku me formularin e aplikimit dhe pasaporta janë të paraqitura në emër të Mirlinda Lllollunit, andaj apeli në fjalë nuk i plotëson kërkesat ashtu siç parashihet me nenin 10.7 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, ku theksohet se: *“Personi që e dorëzon apelimin duhet të përdorë formularin e gatshëm për apelim”*. Të gjitha apelimet duhet të kenë së paku informacionet vijuese:

- a) emrin, adresën dhe informacionet për kontaktim të personit që e dorëzon apelimin
- b) arsyen për dorëzimin e apelimt

c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të personit që e dorëzon apelimin apo udhëzimin se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të parashtruesit të apelimit

d) vërtetimin nga personi që e dorëzon apelimin lidhur me vërtetësinë e përmbajtjes së apelimit.

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në meritat e apelit, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartcekur.

Nga arsyet e lartcekura e në mbështetje të nenit 10.7 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 584/2021 më datën 02.09.2021

**Kryesuesi i Panelit**

Adnan Komushevi

***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.